



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština -Municipality of Prishtina



E K S T R A K T

i procesverbalit të Diskutimit të Përgjithshëm Publik, mbajtur më 23.06.2023, duke filluar nga ora 10:00

Në mbledhje morën pjesë: Përparim Rama-Kryetar, Osman Bllaca-Kryesues, Donjeta Sahatçiu-Nënkryetare, Valbona Makolli- drejtore e Drejtorisë së Financave, Besianë Musmurati- drejtore e Drejtorisë së Arsimit, Doruntinë Maloku- drejtore e Drejtorisë së Pronës, Arbër Sadiki- drejtor i Drejtorisë së Urbanizmit, Krenar Xhaferi- drejtor i Drejtorisë së Investimeve Kapitale, Adelina Sahiti- drejtore e Drejtorisë së Mirëqenies Sociale, Florian Dushi-drejtor i Drejtorisë së Inspeksionit, Donika Çetta- drejtore e Drejtorisë së Parqeve, Ilirik Musliu- drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike, Donat Lushaku- drejtor i Drejtorisë së Kadastrit, Lulzim Fushtica- drejtor i Drejtorisë së Sigurisë dhe Emergjencave, Granit Rugova- drejtori i Drejtorisë së Sportit, Mimoza Sylejmani- drejtore e Drejtorisë së Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit.

Të pranishëm ishin edhe qytetarët: Orhan Avdiu, Rama Cakiqi, Jetullah Beqiri, Denis Krasniqi, Skender Mehmeti, Genc Sopa, Zenun Avdullahi, Ilir Gashi, Driton Prenaj, Rifat Gashi, Ahmet Gashi, Donika Ahmetaj, Besim Gashi, Blerim Gashi, Adnan Haziri, Sami Salihu, Elmire Nikçi-Rexha, Amir Simnica, Fadil Leci.

Osman Bllaca, kryesues hapi diskutimin duke prezantuar të pranishmit, dhe i ftoj diskutuesit ta marrin fjalën me ngritje dore për çfarëdo që iu intereson pyetje apo komente, sugjerime për kryetarin dhe tërë kabinetin.

Orhan Avdiu, qytetar i lagjes “Dardania”, bëri pyetje për Planin Zhvillimor Urban, ku ka mbet, kur do të kryhet dhe kur do të del në diskutim publik.

Përparim Rama, Kryetar tha se PZHK(Plani Zhvillimor Komunal), është pothuajse i përfunduar dhe se vetëm janë në diskutim me UN-Habitat, të cilët janë duke e analizuar dhe diskutuar çështjen e kufirit të Prishtinës të vjetër dhe muajin e ardhshëm del në diskutim publik.

Ram Cakiqi, bëri një pyetje lidhur me Parkun e Qytetit, për lejet të cilat është premtuar se do të lëshohen vitin që shkojë por nuk janë lëshuar as këtë vit dhe se kujt duhet t’i drejtohet ai për to.

Donika Çetta, drejtoreshë u përgjigj se është një grup punues i cili është duke e bërë këtë rregullore për shfrytëzimin e hapësirave në afate kohore të shkurtra.

Doruntinë Maloku, drejtoreshë tha se rregullorja për të cilën po flet drejtoresha Donika, është Rregullorja për Dhënie në Shfrytëzim të Hapësirave Publike, parqeve dhe pronave publike, në shfrytëzim për një afat më pak se 1 vit, për të cilën është mbajtur Dëgjimi Publik, pastaj do të shkojë në votim në asamble dhe do të fillohet me procedurat.

Ram Cakiqi, tha se ka punuar 20 vite në Park të Qytetit, dhe që dy vite nuk i keni dhënë leje askujt, ndërsa në "Taukbahqë" dhe "Gërmi", punojnë pa leje, vetëm në "Park të Qytetit", nuk po lejohet të punohet pa leje dhe dikush të punojë pa leje, e dikujt mos t'i lejohet kjo nuk është e drejtë.

Doruntinë Maloku, drejtoreshë tha se Drejtoria e Pronës, nuk lëshon leje për aktivitete të tilla, pasi që me atë punë janë kompetente drejtoritë tjera.

Përparim Rama, Kryetar foli për Rregulloren që u përmend nga Drejtoresha e Pronës, duke thënë se i ka edhe 20 ditë afat për të u diskutuar, po ashtu është në internet dhe mund të i shohin të gjithë parametrat që duhet plotësuar për marrjen e lejes për më pak se 365 ditë.

Sipas tij, për çdo intervenim nëpër parqe edhe nëse ekziston leja për hapjen e kafes duhet të propozohet një projekt tek Drejtoria e Urbanizmit, pra kjo është procedura e deritanishme, kurse sa i përket pikave të tjera të cilat funksionojnë diku tjetër, nëse ato janë pa leje atëherë me to merret Drejtoria e Inspektionit.

Florian Dushi, drejtor tha se rasti i "Taukbahqes" është një kafene për të cilën është marrë një vendim nga Komuna e Prishtinës që është pezulluar dhe është në procedura me Ministrinë e Mjedisit dhe në Gjykatë, pra nuk është pse lejohet ajo pa leje por sepse ka vendime të organeve më të larta të cilave edhe Komuna duhet të ju nënshtrohet, në "Gërmi", ndërkohë nuk ka kafe që punojnë pa leje t'i vetëm ndoshta e ke fjalën për ndonjë shitës ambulant. Ai tha se nuk është mirë të dezinformohet dhe se Komuna është duke punuar për të gjithë ata që mund të kenë interes të punojnë në hapësirat e gjelbra.

Jetullah Beqiri, përfaqësues i Ansambllit të Këngës dhe Valles "Prishtina" tha se tash e 23 vite komuniteti artistik në Prishtinë që i ka përmbi 500 artistë janë pa lokale, pa gjërat më elementare që duhet t'i ketë një komunitet në qytetin e Prishtinës. Ai tha se vjen nga "Kodra e Trimave", që i ka 75 mijë banorë dhe se është i shqetësuar që nuk ka qendër kulturore, as sallë sportive, dhe as vende ku e zhvillon komuniteti artistik aktivitetin edhe pse që nga viti 2000 ai nuk ka lënë derë pa trokitur për këtë çështje, pra për 100 m² për zhvillimin e aktivitetit dhe për gjëra elementare.

Ai tha se në "Ansamblin Prishtina", i ka 80 artistë që i zhvillojnë aktivitetin dhe e ushtrojnë nëpër korridore, nëpër klasa, përmbi banka. Megjithatë ai falënderojë Drejtorin e këtij mandati dhe gjithë kabinetin pasi që për herë të parë në Prishtinë ka stimuluar më denjësisht, në mënyrë më dinjitoze anëtarët tanë, kurse në të kaluarën kanë marrë 0.0001 cent. Ai u bëri apel të gjithëve Drejtorisë së Urbanizmit dhe drejtorive tjera sepse pa art, pa kulturë, pa rini nuk ka

asgjë dhe se kot rregullohen rrugët kur nuk ka rini. Më herët ai tha se kanë ushtruar në amfiteatrin e Pallatit të Rinisë por Ministria e Kulturës, ua ka ndaluar dhe nuk i ka financuar me asnjë cent që 2 vite.

Ai tha së është e kot edhe nëse iu jepen 100 mijë euro në vit, pasi që ata nuk kanë shtëpi të tyre, nuk kanë zhevshore, nuk kanë ku të përgatiten për festivale, ku nga 11 asamble që kanë qenë më herët tani janë vetëm dy, kurse në tërë Kosovën kanë qenë 300 e tani kanë mbetur 50 sepse nuk kanë kushte. Sipas tij një popull që nuk e mbron kulturën e vet, traditën e vet, një Komunë, një shtet ai është popull i dështuar, kështu që u lut që t'iu sigurohet salla prej 100 m² për t'i zhvilluar aktivitetet.

Përparim Rama, Kryetar theksoj se e kupton frustrimin e këtyre grupeve kulturo-artistike dhe se fokusi i tyre është që të ngritët niveli i artit dhe kulturës, pasi që ka një reaksion pozitiv në ngritje të ekonomisë, ku përveç që kanë subvencionuar një numër të madh të grupeve dhe të Ansambleve të ndryshme, ku tash është nënshkruar kontrata për transformimin e ndërtesës Gërmia këtu në qendër të Prishtinës si sallë multikulturore ku do të kenë një vend të dinjitetshëm për performanca secili grup i kulturës, i valltarëve, e po ashtu edhe në "Kodrën e Trimave", është duke u bërë një projekt rigjenerimi që do t'i shërbej gjithë Prishtinës.

Ai tha se janë duke i ndërtuar 5 shkolla të reja në Kryeqytet, kanë nënshkruar kontratë edhe me IFC dhe për 5 shkolla të tjera pra kanë me qenë 10 shkolla fillore të reja brenda 3 viteve të ardhshme të cilat do të mundësojnë mësimin tërëditor, ku tri prej tyre planifikohet të fillojnë punën në shtator dhe kjo lidhet drejtpërdrejt me kurrikulumit ekstra pra shtesë ku ata mund të zgjedhin vallëzim, performancë etj. prej orën 13:00 mund t'i trajnojnë fëmijët e pastaj Ansambli mund ta përdorë për nevoja të veta pas orën 16:00 dhe se të gjitha këto janë duke ndodhur dhe janë drejt përfundimit. Ai u shpreh optimist dhe se po punojnë për të shkuar përpara për të pasur një realitet të ri më të mirë në të gjitha aspektet.

Denis Krasniqi, bëri disa pyetje. E para ishte për sheshin "Xhorxh Bush", pasi që është shumë e paqartë çka është duke ndodhur me atë shesh, një javë është i bllokuar edhe për autobus edhe për taksi pastaj javën tjetër sheh edhe autobus edhe taksi.

E dyta ishte rreth vendimit të Komunës për qentë endacak ai tha se e ka zgjedhur problemin deri diku.

E treta ishte se ku qëndrojnë me programin rreth digjitalizimit të Prishtinës, i cili ka qenë premtim elektoral i Kryetarit.

Gjithashtu ai deshi të dijë edhe për 4-5 nënkalimet që janë premtuar në zgjedhje, për shtigjet për biçikleta dhe trotinetet si dhe e ceku një premtim për transport publik falas që kishte bërë Uran Ismajli nga PDK-ja, kurse tash bileta është shtrenjtuar dhe janë anashkaluar studentët dhe dua të dijë se a është marrë parasysh kjo kërkesë e Parlamentit Studentor për lirim nga pagesa e biletës. Z. Krasniqi shprehi shqetësimin rrugën kryesore "Agim Ramadani" pasi që nuk ka drita, nga Qendra e Studentëve tash e tre muaj nuk ka drita.

Dhe pyetja e tij e fundit për kryetarin ishte se a ka plan Komuna e Prishtinës të këtë qendër rinore apo jo.

Përparim Rama, Kryetari shpjegoi për sheshin "Xhorxh Bush", ku fillimisht tha se i kanë ndërprerë makinat private dhe i kanë lejuar autobusët dhe taksitë dhe është duke u krijuar dizajni i transformimit të gjithë sheshit "Xhorxh Bush", pra do të jetë vazhdimësi e sheshit "Nëna Terezë" dhe do të mbyllet totalisht për taksitë dhe autobusët, që të jetë hapësirë publike për qytetarë. Ai tha se kjo është një pikë tranzitore dhe se deri në shtator-tetor do të paraqesin projektin e ri të sheshit "Xhorxh Bush" ashtu që në vitin e ardhshëm të filloj ndërtimi dhe transformimi i hapësirës sepse edhe asfaltin do ta heqim.

Transformimi i hapësirave publike do t'i marr parasysh edhe se si t'i trajtojmë reshjet atmosferike, si ti absorbojmë ujërat e shumtë që kanë shkaktuar vërshime. Kryetari u shpreh së është një qasje e re se si do të ridizajnohen hapësirat publike për të krijuar hapësira të mirëfillta për secilën demografi, që nga fëmijët deri tek mosha e tretë ndërsa për ta zbutur nivelin klimatik gjatë verës kur asfalti krijon një nxehtësi shumë të madhe do të mbjellën drunjtë dhe do të krijohen hapësira tjera të gjelbra të cilat do t'i ndihmojmë këtij aspekti në mënyrë që të këtë hapësirë publike për secilin qytetar.

Ai tha se një fazë vazhdon deri tek "Posta", kurse faza tjetër deri te "Flamuri" që të krijohet lidhja e lagjeve të Kryeqytetit prej "Lagjes së spitalit", lagjja "Emshir", "Dardani", "Ulpiana", "Qendër", "Bregu i Diellit", "Prishtina e vjetër", "Kolovica, ndërsa nënkalimet veç janë duke u dizajnuar, ku kompania e ka fituar tenderin për ndërlidhjen e "Dardanisë" me "Emshir".

Ai tha se për të ju përshtatur fluksit të madh të makinave, kërkohet një strategji holistike, jo vetëm me thënë po e bëjmë këtë rrugë, por intervenimi në këtë rrugë me çka ndërlidhet ose ndërtimi i këtyre 5 shkollave fillimisht, edhe 5 shkollave përreth Prishtinës, në zonat e reja krijon atë që kryetari ka premtuar "Qytetin shtatë minutësh", që do të thotë që aty ku jeton me pas shkollën, qendrën e mjekësisë familjare, qendrën kulturore, pra të gjitha nevojat jetësore me i pas aty ku jeton dhe në këtë mënyrë të minimizohet nevoja për të udhëtuar, dhe si alternativë për udhëtim të këtë autobusët, trotinetet dhe biçikletat.

Ai tha se me "Trafikun Urban" "IBRD", kanë nënshkruar kontratën 10 milionëshe, për 30 autobusë të ri dhe se janë në negociatë edhe për 50 kombibusë tjerë elektrik, po ashtu me "World Bank", është bërë projekti për linjat e autobusëve me ditë në orën 10:00 vjen autobusi në orën 10:15 e din që je në pikën tjetër. Po ashtu ai me "Bankën Raiffeisen" edhe me "NLB", ka diskutuar për ta krijuar "Kartelën e Qytetit", e cila ja u mundëson secilit qytetarë që në mënyrë digjitale me hipë në një autobusë dhe me lidhë edhe trafikun urban me sektorin privat. Për shtigjet e biçikletave ai tha se të gjitha projektet e reja që kanë filluar i kanë të dedikuara shtigjet për biçikleta, bashkë me shenjëzimin, e po ashtu është duke u bërë autostrada e parë e biçikletave bashkë me Komunën e Kamenicës, nga Prishtina në Kamenicë.

Për aspektin e lirimit të studentëve nga pagesa e "Trafikut Urban" tha se nuk ka ndodhur për shkak të kontratës me IBRD-në që bazohet në të hyrat e TU por se ka biseda për ta ndërruar

kontratën që të mundësohet pastaj lirimi i studentëve nga pagesa. Për dritat në rr. "Agim Ramadani" ai tha se e ka pyetur Ilirikun para tri jave dhe se janë rregulluar por që dikush po i ndalë në pikë, e cila duhet të sigurohet që mos të ndalen më.

Denis Krasniqi, tha se ai kalon aty çdo natë dhe nuk ka drita dhe se kjo po ndodhë qe 3-4 muaj.

Përparim Rama, Kryetari tha se kalon shpesh aty dhe se nuk është ashtu por në bazë të informatave dikush e ndal por që do të rregullohet. Qendra e Rinisë, "Pallati i Rinisë" ai tha se është bashkë me EIB me fond prej 450 mijë euro, që të bëhet ajo pika kyçe siç ka qenë më parë, për sport dhe teknologji, ku ka pas diskutime me STIC dhe ICK për tu krijuar unaza e teknologjisë dhe salla tjetër që ende është e djegur të kthehet në sallë multifunksionale. Tjetër element ai ceku "Arenën Multifunksionale" në Bërnice të poshtme e cila do të shfrytëzohet për sporte dhe evente tjera të artit dhe sportit. Po ashtu ai tha se "Qendra Olimpikë", do ta ketë stadiumin e futbollit, pishinën olimpikë, tenis, xhudo, pingpong etj.

Ilirik Musliu, drejtor shtoi se i kanë edhe dy nënkalime, njëri është depërtimi i Veterrikut me rrugën A, në të cilën është përzgjedhur kompania por ka shkuar në OSHP, si lëndë, në momentin që kthehet edhe ai projekt do të finalizohet dhe do të dizajnohet, si dhe tunelin në rrugën "Agim Ramadani", i cili është në fazën e përfundimit të aplikimit të kompanive projektuese, me idenë që në shtator të buxhetohet, dhe vitin tjetër të fillojë edhe ky projekt.

Skender Mehmeti, pyeti për një problem 10 vjeçar që i është paraqitur atij dhe bashkëpronarëve të disa trojeve në "Prishtinën e Re", pasi që qe 10 vite nuk po mund të marrin leje ndërtimi, as të shesin prona, pasi aty është bërë riparcializimi i parcelave, dhe se dëshiron të dijë se çka do të ndodhë tutje.

Arbër Sadiki, drejtor theksojë se këtë problematikë e kanë gjithsecili rreth "Prishtinës së Re" ku aty janë disa ndarje të cilat dikush kur i ka ndarë e ka paraparë edhe një rrugë dhe një mundësi që secili të mund të zhvillohet, mirëpo kur është bërë plani për atë zonë, në masën më të madhe nuk ka përputhje të tillë dhe kjo pamundëson lëshimin e lejeve për shkak të mospërputhjes së planit me parcelën urbanistike. Si pasoj e shqetësimeve të shumta ai tha se janë në atë pikë që duhet rishqyrtuar plani në kuptimin e barazimit të ndarjes kadastrale me parcelat urbanistike, përmes një shqyrtimi të Planit Rregullativ ekzistues.

Genc Sopa, bëri pyetje rreth Spitalit të Prishtinës, se ku ka mbërri dhe çka është bërë dhe se ligji për shëndetësi, thotë që Kryeqyteti e themelon Spitalin e Prishtinës, pra është një mundësi por edhe obligim i Kryeqytetit për ta themeluar juridikisht spitalin. Ai tha se e ka parë që është diskutuar për këtë temë dhe se e din që ekziston studimi i fizibilitetit dhe një plan për Spitalin e Prishtinës por se nuk ka mund të gjejë një vendim online për parcelë ose vendlokacion.

Përparim Rama, Kryetari tha se në bazë të ligjit të Kryeqytetit ndërtimi dhe menaxhimi i Spitalit të Kryeqytetit i takon Kryeqytetit dhe është iniciuar, toka dhe parcela janë të dedikuara për të afër Pallatit të Drejtësisë, ku kompania ICME, janë duke punuar në këtë drejtim. Për Spitalin e Kryeqytetit, ai tha se është dedikuar buxheti, ku 1 milion janë dedikuar për me pas vijnë buxhetore, ndërsa spitali kushton diku 35 milion euro. Ai theksoi se kanë biseduar me Ministrin e Shëndetësisë edhe për QKUK-në,

sepse shërbimet të cilat kryhen prej SHSKUK-së, janë jo të nivelit ë duhur, kështu që krijimi i Spitalit të Kryeqytetit në këtë zonë i kishte mundësuar edhe ritransformimin total edhe të shërbimit terciar pra të krijimit të një qendre komplet të re jo domosdoshmërisht aty.

Po ashtu në aspektin financiar kishte mundur të ndodhë ndonjë zhvillim, ndonjë partneritet publiko-privat, që kishte mundësuar me ndërtuar Spitalin e ri Terciar, prej fondeve që kishin ardhur nga ky partneritet.

Genc Sopa, tha se janë duke bërë hapa drejt themelimit të spitalit ende pa pasur themelimit juridik të tij si institucion, se derisa nuk ekziston juridikisht statuti i Spitalit të Prishtinës, krejt projektet çka i bënë Ministria, askund nuk do ta përfshijë Spitalin e Prishtinës.

Përparim Rama, Kryetari tha se në aspektin procedural në aspektin burokratik, nuk i ndalon asgjë me i bërë këto në mënyrë paralele dhe se janë të obliguar në bazë të ligjit të Kryeqytetit me e pas Spitalin e Kryeqytetit, sepse është një borxh ndaj qytetarëve të Kryeqytetit.

Qytetarët tanë janë të vetmit që shtyhen e presin rend me gjithë qytetarët e Kosovës, ndërsa qytetarët e zonave tjera i kanë Spitalet e veta sekondare, dhe nuk kanë qytetarë tjerë të Kosovës që shkojnë atje për shërbim sekondar, kjo ndodhë vetëm në Prishtinë.

Zenun Avdullahi, tha se ka shtëpinë në lagjen Prishtina e Re në Veternik, ku me plan urbanistik e ka rrok rrugë, ku është rregulluar Ambulanta e re aty dhe se ai nuk mundet as të ndërtojë shtëpi aty. Ai pyeti se a po ndryshon Plani Rregullues diçka.

Përparim Rama, Kryetari shpjegoi se nëse parcela në bazë të Planit Rregullativ dedikohet si rrugë, atëherë ajo paguhet ose shpronësohet, në 3 mënyra: me tu paguar, me tu shpronësuar diku tjetër dhe me tu shndërruar në koeficient ndërtimi. Aty ka pas me qenë unaza e mesme, e tash më nuk ka me pas unazë të mesme ka me qenë vetëm unaza e Kryeqytetit e cila është shtyrë më poshtë, të përroi i Hajvalisë dhe kjo ka me qenë prapë rrugë por jo e madhe siç kishte me qenë unaza e mesme.

Mimoza Sylejmani, drejtore tha se mund të shkojnë të enjteve prej orës 09:00, në katin e dytë tek Drejtorja e Planifikimit Strategjik dhe Zhvillim të Qëndrueshëm, dhe të diskutohen të gjitha këto probleme.

Qytetari, pyeti për “Kodrën e Trimave” që është një pjesë problematike se një pjesë është e Komunës, një pjesë është blerë para 40 viteve, kanë vdekur njerëzit dhe nuk po mundën ti përkthejnë, duke pyetur se çfarë zgjidhje është paraparë.

Përparim Rama, Kryetari tha se “Kodra e Trimave”, e ka problemin kompleks dhe për këtë arsye nëpërmjet planit të rigjenerimit tash janë duke bërë planifikime për rigjenerim të “Kodrës së Trimave”. Po ashtu ai tha se zyra ligjore është duke punuar në një rregullore që ju mundëson banorëve që kanë banuar aty me dekada, e kanë ndërtuar shtëpinë në tokë të Komunës me ua pranuar pronësinë e shtëpisë me një rregullore që me mundur me ‘u bërë pjesë e zhvillimit të ri ose edhe me mund me shitë apo me ble.

Ilir Gashi, banor në lagjen “Veternik”, rruga “Feniksët e Lirisë”, tha së pronën e tij dhe të shumë komshinjeve e ka rrokë unaza e tretë e qytetit dhe ajo unazë tash ka dalë pak më poshtë. Sipas planit

urbanistik 2013-2023, nuk ka mundë të marrë leje sepse bash në unazë ia ka rrokë tokën, pra që 10 vite ka qenë i bllokuar dhe ende nuk ka ndonjë plan konkret.

Ai tha se dëshiron ta di se a do të ketë ndonjë plan konkret apo do të jetë pjesë e ndërtimit të lartë edhe ajo pjesë deri në unazën e tretë apo çka do të behët me atë pjesë aty.

Përparim Rama, Kryetari tha se të gjitha këto prona që janë në aspektin e Planeve Rregullative ekzistuese ku është e dedikuar prona si rrugë, shkollë apo çka do që është në aspektin e të mirës publike, siç e ceku edhe më herët janë 3 mënyra: shpronësimi me pagesë, tokenizimi si koeficient, me përdorë në pjesë tjera të Prishtinës, ose ndërrimi shpronësimi ku e merr prej asaj pronë e zgjedhë një pronë tjetër që është tash e Komunës.

Krenar Xhaferi, drejtori tha se unaza e tretë del prej funksionit në momentin që miratohet plani për unazën e qytetit, pra ajo lirohet dhe faktikisht lirohen ato prona në kuptim që Urbanizmi me hartë zonale ta rregullojë pjesën tjetër.

Ilir Gashi, pyeti se a do të kemi ndonjë ndërtim apo sepse kanë qenë qe 10 vite të bllokuar dhe pjesa tjetër që ka mbete jashtë planit, a do të hyn edhe ajo në Plan Urbanistik brenda unazës apo jo.

Krenar Xhaferi, drejtor tha se janë duke punuar dhe janë në fazën finale të realizimit të unazës e cila del në diskutim publik që ndoshta brenda korrikut, me dal në diskutim publik, përmbillet dhe lirohet pjesa tjetër e unazës në të cilën z. Ilir e ka pronën. Drejtori ceku se kanë pasur shumë banorë të cilët janë ballafaquar me këtë problem dhe as nuk kanë mund të marrin leje por në të njëjtën kohë janë bllokuar vite të tëra sa i përket pjesës së unazës.

Ilir Gashi, tha se gjysmën e tokës e ka në unazë e gjysmën jashtë Planit Urbanistik dhe se a do të hyn edhe ajo në Planin Urbanistik apo do të mbetet jashtë Planit Urbanistik.

Përparim Rama, Kryetari u përgjigj se të gjitha pjesët e Kryeqytetit pas miratimit të Planit Zhvillimor Komunal kanë me u transformuar në harta zonale, me u shqyrtuar nëpërmjet hartës zonale, pra do të shqyrtohet dhe do të dihet çka do të mund të bësh aty e çka jo.

Arbër Sadiki, drejtor tha se s'ka me mbete pa u trajtuar asgjë, deri sa PZHU-ja, e ka pas një kufi deri ku është shtrirë, harta zonale përfshinë komplet.

Ilir Gashi, pyeti për PZHU-në, se a do të ketë ndonjë afat kohor.

Arbër Sadiki, drejtor u përgjigje duke thënë se s'ka PZHU, më por vetëm Plan Zhvillimor Komunal, i cili është në fazën finale për ta hedhur në diskutim publik dhe harta zonale që e trajton pastaj tërë territorin e Komunës së Prishtinës, jo vetëm zonën urbane.

Osman Bllaca, kryesues falënderojë drejtorët dhe qytetarët për pjesëmarrje duke e përmbyllur këtë diskutim.



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina



Diskutim publik i përgjithshëm
23 Qershor, 2023
Kryeqyteti - Prishtinë / Kuvendi Komunal

Nr.	Emri/Name	Mbiemri/Surname	Titulli/Title	e-mail	Nënshkrimi/Signature
1	Yolallo G	Prellas			
2	Orhan	Ardiu			
3	Dritan	Prengaj			
4	GENT	SOPA			
5	Rifat	Jodhy. K			
6	AMLET	GASHI			
7	Donika	Almetaj			
8	SKENDER M	MCHIMCI			
9	BOJIM	GASHI			
10	OLERIM	BASTI			

*P.S *Të dhënat tuaja personale do të përdoren vetëm për qëllime të evidentimit të pjesëmarrësve në konsultim publik dhe nuk do të përdoren për qëllime tjera!*

Pjesëmarrësit janë të njoftuar se gjatë diskutimeve publike, do të fotografohet dhe do të publikohen!

Nr.	Emri/Name	Mbiemri/Surname	Titulli/Title	e-mail	Nënshkrimi/Signature
11	ZENUN	Abdullahi			
12	Adnan	Haxhi			
13	SAMI	SALIHU			
14	ELNIKE	NIKGI REXHA			
15	AMIR	SIMNICA			
16	Denix	Krasniqi			
17	RAMA	CHIKI			
18	FADIL LEÇI				
19					
20					
21					
22					
23					
24					
25					
26					
27					
28					

P.S *Të dhënat tuaja personale do të përdoren vetëm për qëllime të evidentimit të pjesëmarrësve në konsultim publik dhe nuk do të përdoren për qëllime tjera!

Pjesëmarrësit janë të njoftuar se gjatë diskutimeve publike, do të fotografohet dhe do të publikohen!